



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 7/15

Prishtinë, më 18.2.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Besa Gaxherri, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Bardhyl Meta, Bojan Mitić dhe Labinotë Demi-Murtezi.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi - zv. Ministër i Financave dhe Hasan Isufaj - zv. Drejtor i Buxhetit Qendror në MF, Mentor Borovci, u.d. Sekretar në Ministrinë e Diasporës, Naim Dedushaj nga MD, Shpresa Rama nga MD, Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Alexandra Fehlinger nga GIZ, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Jetmir Bakija nga KDI, Sanije Berisha nga OSCE dhe Liridon Llapashtica nga Gazeta Zëri.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 30.1.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Diasporës për aprovimin e pagesës në paradhënie për financimin e projekteve të Ministrisë;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari- konstatohet se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 30.1.2015

Kryetari - konstatohet se komisioni miratoi procesverbalin pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Diasporës për aprovimin e pagesës në paradhënie për financimin e projekteve të Ministrisë

Kryetari - njofton se ministria e diasporës ka bërë një kërkesë për miratimin e paradhënies në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, për realizimin e disa projekteve nga kjo ministri në përkrahjen e diasporës shqiptare në vende të ndryshme dhe shuma totale që kërkohet për paradhënie është 81,800 euro. Kërkesa është bërë mbështetur në nenin 11.2 të Ligjit të buxheti të Kosovës për vitin 2015, sipas të cilit qeveria mund ta aprovoj pagesën e paradhënies prej me shumë se 30% deri në 100%, të vlerës së kontratës për mallra dhe shërbime, vetëm pas rekomandimit të komisionit për buxhet e financa.

Mentor Borovci – theksoi se bazuar në ligjin për diasporën, e kemi mandatin për ruajtjen e identitetit të diasporës dhe të mërgatës, ne e kemi një plan të punës dhe pjesë e kësaj kërkesë janë një sërë aktivitete. Këto aktivitete kërkojnë aprovimin në avancë të mjeteve, në të kundërtën ato nuk mund të realizohen. Pra janë disa aktivitete që duhet financohen paraprakisht, siç është rasti me krijimin e një rrjeti të bizneseve, neve na kërkohet që ta rezervojmë një sallë dhe përgatitjet tjera për takimin, dhe për këtë aktivitet dhe aktivitete të ngjashme, ne duhet të bëjmë pagesën në avans.

Safete Hadergjonaj – njoftoi se edhe në mandatin e kaluar e kemi pasur një kërkesën të ngjashme, nga e njëjta ministri për realizimin e disa aktiviteteve dhe për shkak të mos-përmbushjes së kushteve ligjore nuk kemi mundur të rekomandojmë për gjithë aktivitetet, por vetëm për atë që ka përmbushur kushtet ligjore. Do të ishte mirë që edhe ju si ministri, për shkak të specifikave që keni, që të insistoni që kjo çështje të rregullohet dhe të bëheshin ndryshimet në ligj, sa i përket financimit të aktiviteteve përmes paradhënies. Unë e kuptoj natyrën e projekteve të Ministrisë së Diasporës, sepse nuk është krejt e lehtë me lidhë kontrata, por megjithatë kemi problem me ligj me procedue në këtë formë siç ka ardhur kërkesa. Unë kisha sugjeruar që të shikohet ndonjë mënyrë tjetër me gjet zgjidhje, që ministria me i krye aktivitetet e tyre, por që në të njëjtën kohë që ne nuk biem në kontradiktë me ligjin.

Latif Gashi - theksoi se edhe më herët kam qenë pro kërkesës së ministrisë, dhe këtë problem e pasur edhe vitin e kaluar, dhe po shihet se nuk është ndërmarr asnjë veprim për të bërë përmirësimet ligjore. Duke ditur natyrën e punës së ministrisë dhe duke parë rëndësinë e këtyre projekteve për diasporën, iu kisha lutur të gjithëve me e aprovue këtë kërkesë. Sigurisht që ministria është përgjegjëse me deshmue dhe arsyetue për shpenzimet e buxhetit të tyre, dhe pjesë e kësaj është edhe prezantimi i kontratave që do ti bëjnë. Unë si jurist them se ligji interpretohet varësisht prej nevojës konkrete dhe nevoja konkrete është me e lejuar kërkesën e ministrisë së diasporës.

Besa Gaxherri - sa i përket procedurave normal se janë të rëndësishme për ne, por unë mendoj se për gjëra të tilla siç është rasti i funksionimit të kësaj ministrie, nuk është dashur të jenë pengesë procedurat në realizimin e aktiviteteve dhe nëse është një zgjidhje që natyrisht është në pajtim me ligjin, unë e jap pëlqimin tim. Por realisht, unë e kuptoj se është vështirë të na prezantohen të gjitha pro-faturat paraprakisht, për këto aktivitete specifike, por duke ditur natyrën e punës së ministrisë është dashur me kohë të bëhen ndryshimet në ligj, duke pasur parasysh specifikat e kësaj ministrie.

Kryetari – citoi paragrafi 2 të nenit 11 të ligjit, ku se duhet prezantuar vlerën e kontratës për mallra e shërbime, vetëm pas rekomandimit të komisionit për buxhet e financa. Në kërkesën e ministrisë nuk janë prezantuar kontratat dhe pa kontrata nuk mundemi me dhënë pëlqimin, sepse ne e shkelim ligjin për buxhet.

Enver Hoti - pajtohem me vërejtjet ligjore për lidhshmërinë e pagesës në realizimin kërkesave, por në anën tjetër të gjitha këto aktivitete për diasporën, janë shumë të rëndësishme kur dihet kontributi i diasporës për Kosovën, dhe janë çështje me interes në integrimin e diasporës dhe për ruajtjen e vlerave

dhe traditave. Pyetja ime është pse ministria e diasporës nuk ka kapacitete me i realizue vetë këto aktivitete dhe duhet me shkue përmes shoqatave apo organizatave të ndryshme jofitimprurëse, dhe kjo për mua është pak e pa arsyeshme.

Agim Krasniqi - sqaroj se mbi bazën e ligjit të buxhetit edhe ligjit të prokurimit publik, janë hartuar rregullat e thesarit, që kanë të bëjnë më menaxhimin e parasë publike, duke përfshi edhe avanset në këtë rast. Nëse aprovohet kjo kërkesë e ministrisë, këto rregulla shkelen dhe nëse duam me diçka duhet të ndërrojmë legjislacionin edhe rregullat, përndryshe siç është përcaktuar me ligjin e buxhetit 2015, nuk lejohet një gjë e tillë.

Latif Gashi – duke iu drejtuar zv. ministrit, pyeti çfarë keni vepruar si qeveri që 12 vite, dhe çfarë doni të veproni që ministrinë e diasporës ta bëni funksionale dhe nëse këto projekte dështojnë, atëherë çfarë kuptimi ka të thuhet që ne si institucione po kujdesemi për njerëzit e diasporës. Pse nuk keni ndërmarr masa me propozue ndryshime ligjore që me funksionue normalisht kjo ministri.

Naim Dedushaj – njoftoi se në vitin e kaluar kemi themeluar një prej bizneseve gjithë shqiptare në botë me një përkushtim të madh kam arrit me i bë bashkë shumë biznesmen dhe për të arritur këtë kemi pasur edhe shumë pengesa për shkak edhe të procedurave dhe duke ju falënderuar UNDP-së, bashkatdhetarëve, në shumicën e rasteve të aktiviteteve i kemi krye vet prej gjepit tonë apo me ndihmën e tyre. Janë edhe aktivitet tjera që kemi zhvilluar siç është rasti i themelimit të unioneve apo dhjetrave bizneseve dhe këto projekte që i kemi planifikuar janë në shuma kryesisht të vogla. Nëse nuk lejohet kjo formë e pagesës ne duhet të tërhiqem prej këtyre projekteve sepse nuk ka mundësi të realizohen ndryshe.

Kryetari - është çështje e juaja si punoni dhe organizoni aktivitetet dhe nuk është çështje e deputetit fare, dhe ne nuk mund të shkelim ligjin për askënd dhe ligji është i njëjtë për të gjitha institucionet.

Besa Gaxherri - ligji për buxhetin është i njëjtë për të gjitha ministrinë dhe për të gjitha organizata buxhetore. Në lidhje me projektet, e morret shembull themelimin e unioneve të bizneseve, unë mendojë që është krejtësisht e paarsyeshme që të merret ministria e diasporës më këto çështje, kur e kemi ministrinë e punëve të jashtme, ministrinë e tregtisë dhe industrisë, që janë kompetente për këto aktivitete. Unë mendojë është mirë me u orientue në projekte që e prekni direkt diasporën, dhe nuk keni nevojë të merreni me themelimin e unioneve, as me u marr me punën të kësaj natyre. Ligji është ligj dhe nuk jemi për me e shkel, por unë jam për me e mbështet këtë ministri, por kurrfarë çështje personale nuk kemi.

Mentor Borovci – theksoi se ministria e diasporës është e mandatuar me u marrë edhe me çështjen e tërheqjes së investimeve të diasporës, dhe të gjitha çështjet që janë të lidhura me diasporën kemi mandat ligjor me u marrë që kanë të bëjnë edhe me ruajtjen e identitetit. Nëse e shihni kërkesën ne kemi shumë kuize të diturisë dhe është vështirë të organizohen ndryshe kur dihet se duhet paguhet dikush me i bë pyetjet, rezervimi i sallës, etj. Po ashtu edhe aktivitete të tjera siç është çështja e shoqatave të mësueseve, takime e seminare, si mund të organizohen këto aktivitete nëse nuk bëhen pagesat avans. Na si ministri po kërkojmë vetëm proceduralisht me u lejue kjo dhe ju siguroj se do të raportojmë me kontrata dhe faktura dhe të gjitha do ti realizojmë konform ligjit.

Fikrim Damka - pse nuk është kontraktuar një kompani në Kosovë, që do të ofronte këto shërbime dhe do të organizonte krejt këto aktivitete në emër të ministrisë dhe do të ekzistonte një kontratë, dhe ju si ministri do të bënit pagesën kësaj kompanie?

Safete Hadergjonaj – a keni bërë ndonjë kontratë për projektin që është planifikuar të realizohet në Australi për muajin shkurt, a është bërë rezervimi i sallës dhe çështjet tjera organizative, pasi që e dimë

që në Australi nuk mundeni me rezervue sallën sot për nesër? E dyta a mundeni të më tregoni se si i vitin e kaluar i keni realizuar projektet që ndërliken me diasporën, të cilat ne nuk i kemi kaluar në komision, për shkak të pengesave ligjore, a janë anuluar të gjitha takimet apo si e keni gjetur zgjidhjen?

Mentor Borovci – theksoi se një sërë aktivitete janë bërë në bashkëpunim me UNDP-së, që e ka paguar paraprakisht dhe kemi pas raste që vet mërgimtarët tanë e kanë paguar sallën, por ku është çështja e dinjitetit të një shteti, ne po shkojmë atje po bëjmë projekte qeveritare e mërgata na pagan sallën e aktivitete tjera.

Latif Gashi - unë kisha kërkuar prej zv. ministrit me e zgjidh këtë problem, sepse e di që ka zgjidhje. Nëse nuk ka zgjidhje juridike atëherë, zv. ministër unë si deputet por besojë që gjithë deputetet kërkojmë, që qeveria ta diskutojë këtë çështje dhe të dërgoni një plotësim-ndryshim të nenit adekuat ose te gjeni një zgjidhje tjetër.

Enver Hoti – theksoi se shuma është simbolike në realizimin e këtyre projekteve dhe projektet janë shumë përmbajtjesore, dhe kisha pas dëshirë të kuptohemi drejtë si deputetë, se nuk kemi asgjë kundër por shprehim admirimin të madh për diasporën. Lidhur me projektin me organizatat jofitimprurëse, përgjigja juaj, për mua nuk është shumë e bindshme. Por këtu shihet edhe aspekti i mosbashkëpunimit ndërministror. Po shihet se nuk i keni përcjell kërkesat në ministrinë e arsimit për aktivitete të cilat kanë të bëjnë me kulturë dhe me arsim. Pse nuk i përdorni kapacitetet që i ka ministria e arsimit apo të ministrisë së tregtisë dhe industrisë që u përmend nga kolegja, për projektet e unioneve të bizneseve? Apo pse nuk bashkëpunoni me ministrinë e drejtësisë, në projektin që ka të bëjë me krijimin e rrjetëzimit të juristëve? Unë ju kuptoj që keni kapacitete të pakta brenda ministrisë së diasporës, por do të ishte më e drejtë të kërkohej kapacitete shtesë brenda ministrisë, por njëkohësisht të shfrytëzohen edhe kapacitetet tjera në ministrinë e linjave, që kanë në këto aktivitete.

Agim Krasniqi – të gjithë jemi interesuar me gjet zgjidhje dhe për ti zhvilluar projektet është ndarë edhe buxheti. Ashtu siç edhe thash më herët, jam konsultuar me thesarin se ekzistojnë rregullat që pamundësojnë realizimin e projekteve në këtë formë si po kërkohet, pavarësisht që të gjithë këto projekte i vlerësojmë pozitive. Unë propozoj që ministria e financave dhe ministria e diasporës, bashkërisht të diskutojnë këtë kërkesë dhe të shikohen mundësitë e rregullimeve të brendshme buxhetore, në mënyrë që me shikue për mos me i trajtue njëfarë forme mallra e shërbime, por me i trajtue si subvencione. Pra brenda kornizës ligjore, të shikojmë formën e financimit të projekteve.

Kryetari - ne nuk do të marrim vendim, por po e autorizojmë ministrinë e financave, bashkë me ministrinë e diasporës, le ta shqyrtojnë formën e realizimit të kërkesave.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Ministria e Financave dhe Ministria e Diasporës, të diskutojnë dhe të gjejnë formën e realizimit të kërkesave të Ministrisë së Diasporës, brenda rregullatve ligjore në fuqi.

4. Shqyrtimi i Raportit të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014

Kryetari – theksoi se kemi marrë me kohë raportin dhe është përgatitur teknikisht mirë, por është bërë edhe një gabim teknik që duhet me përmirësue, pasi që në një tabelë 4d, janë prezantuar të dhënat për nënujorin dhe është dashur të jenë për një vit.

Ismet Krasniqi – prezantoi raportin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, në shuma dhe përqindje. Theksoi se zgjedhjet dhe mos-konstituimi i Kuvendit kanë ndikuar edhe në realizimin e shpenzimeve. Sa i përket investimeve kapitale, procedurat e prokurimit kanë ndikuar në përsëritjen e tenderëve dhe kjo ka ndikuar edhe në nivelin e shpenzimeve.

Besa Gaxherri – konkretisht pse nuk janë realizuar investimet kapitale, në shumatat e planifikuara?

Ismet Krasniqi - sqaroi se anulimi i projektit të renovimit të ndërtesës së Kuvendit, ka ndikuar në masë të madhe në përqindjen e realizimit të projekteve kapitale.

Kryetari – për nivelin e ulët të investimeve kapitale, ka pasur vërejtje të vazhdueshme edhe nga auditori i jashtëm. Një çështje që është diskutuar disa herë dhe që ende nuk ka zgjidhje ka të bëjë me projektin e qendrës protokollare në gërmirë, për të cilin kërkohet që ti ipet fund kësaj pune. Në rekomandimin e komisionit për Kryesinë e Kuvendit, propozojë që të jetë një pikë edhe për këtë çështje.

Safete Hadergjonaj – sa i përket projektit “Vila Gërmija”, komisioni ka qenë i gatshëm me dhënë çdo herë kontributin e vetë, në zgjidhjen e këtij problemi. Kemi bërë edhe kërkesa si komision për Kryesinë e Kuvendit, por Kryesia kurrë nuk na ka dhënë asnjë përgjigje për këtë çështje. Prandaj ju si sekretar i kuvendit, që i koordinoni punët edhe me Kryesinë e Kuvendit, ju kisha lutë të ngritin këtë çështje dhe të fillojmë të zgjedhim këtë problem. Çështja tjetër është se për çdo vit po bëhen meremetime për zyre, ndërrim të dritareve e inventar tjetër, dhe është mandati i pestë dhe ne ende nuk kemi një zyrë për deputet.

Latif Gashi - temat që u ngritën për çfarë investimesh janë bërë dhe çka nuk është bërë, nuk është për me diskutue tani sepse janë organet tjera që e shikojnë mënyrën e shpenzimit të buxhetit, siç është auditimi i brendshëm dhe i jashtëm. Kuvendi e ka sjellur një raport të mirë. Sa i përket investimeve deri ne shpalljen e pavarësisë, përveç Kuvendit që ka qenë në objekt të vetin, 80% e institucioneve tjera shtetërore, kanë qenë të vendosura në shtëpi private, e sot jam e bindur se 90% janë në objekte shtetërore, kjo edhe për faktin se ka pasur shumë investime kapitale nga buxheti total. A ka pasur nevojë për këto investime, unë them po, pra ka pas nevojë për me u investue dhe është investuar.

Besa Gaxherri – mendojë se është më shumë se fyerje për një deputetë që mos të ketë zyrë dhe kushte normale për punë. Ne e dimë se kemi trajtuar çështje të ndryshme, tema shpejtë e shpejtë, kërkesa buxhetore dhe deputetët kurrë nuk janë marrë me vetveten. Ato ministritë që janë bërë dje kanë zyrë, vetura e shofera, e pagën më të mirë se ne, dhe vijnë e na shesin mend, por kush ka faj, ne vet. Nëse ndërtesa e Kuvendit nuk ka zyrë të mjaftueshme, duhet ndërtuar aneks, në mënyrë që të krijohen hapësira dhe kushte për punën për deputetët. Realizmi i projektit së qendrës së protokollare në gërmirë duhet urgjentisht të rifillojë punën, dhe kjo do të ndikojë edhe në bartjen e nivelit të lartë dhe në këtë mënyrë lëshohen hapësira dhe ndoshta nuk ka nevojë me ndërtue aneks për zyrë për deputetë. Në aspektin teknik raporti është më i mirë se të tjerët, por është tjetër kur i analizojmë gjërat nga të dhënat në raport. Prandaj, duhet seriozisht, që deri në rishikim të buxhetit, tek investimet kapitale, duhet me u ulë dhe me diskutue, që të krijohen zyrë për punë për deputetët.

Kryetari - unë mendojë që deri ne rishikim të buxhetit duhet të kemi të definuar çështjen ligjore me qendrën protokollare. Kryesia e Kuvendit, duhet me dhënë një përgjigje komisionit për buxhet e financa, që ata të kërkojnë mjete për me përfundue punën në qendrën protokollare.

Fikrim Damka - desha një sqarim për pagesën e stafit mbështetës politikë, sidomos asistentet e grupeve parlamentare, ku për disa muaj kanë mbet pa paga. Ata kanë vazhduar të punojnë në shërbim të deputetëve, edhe gjatë kohës së nuk është formuar Kuvendi, dhe nuk janë paguar. Pra nuk kanë marr

rroga 5 apo 6 muaj edhe pse kanë dalur në punë për çdo ditë i kanë informuar deputetët për punë dhe iu kanë shpërndarë materialet e nevojshme?

Safete Hadergjona – një shumë prej 10,000 euro për gjykata, për çfarë është paguar kjo shumë? Po ashtu shpenzimet për mallra dhe shërbime po më duken të larta, kur dihet se nuk kemi punuar disa muaj vitin e kaluar?

Latif Gashi – mendojë që në raport me kushtet e qytetarëve të Kosovës, deputetët janë të privilegjuar sa i përket pagave. Sa i përket qendrës protokollare, ne kemi diskutuar edhe në të kaluarën dhe jemi për me investue në atë qendër, por me sa kemi informacion, është në kontest gjyqësor, e deri sa është kështu, nuk e di se si të investohet aty.

Besa Gaxherri - gjithmonë atë çka e flas kam dëshirë me ndëgjue të gjithë qytetarët, e nuk po bëjë krahasime me qytetarët, por me ministra, drejtorët e dikastereve. Po ashtu qytetarët duhet me e ditë që ku e ka deputeti zyrën. Sa i përket të ardhurave të deputetët, kjo varet se sa i angazhuar është deputeti në punë tjera, se ndoshta ka edhe të ardhura të tjera, por unë me këtë pagë udhëtoj dhe e mbaj familjen.

Safete Hadergjona - nuk është e njëjtë se si për ata deputetë që jetojnë në Prishtinë, e si për ata që udhëtojmë. Nuk është logjike me qendruar në holl të Kuvendit me i realizue takime si deputetë. Çështje e mungesës së zyrave për deputetët nuk është temë tani, por prej vitit 2004, kur unë jam deputete dhe ky problem nuk është zgjedh asnjëherë. Unë nuk po kërkoj privilegje, por po kërkoj kushte punë, ku me i lënë letrat e dokumentet e punës.

Latif Gashi - deputet që udhëtojnë në këtë rast, dy koleget kanë beneficinin apo pagesën për udhëtim, Meqë mu referuat mua, edhe unë jetoj me pagën e Kuvendit.

Enver Hoti - raporti i Kuvendit është mirë i përgatitur dhe i ka përmbledhë të gjitha ato aktivitete që janë realizuar, është mirë i përshkruar dhe e mbështes. Por, sigurisht është pak shqetësuese realizimi i investimeve kapitale, në vlerë prej 40%. Nëse investime kapitale janë planifikuar është dashur me u realizue brenda mundësive dhe kjo është një vërejtje, e cila vlenë për tu diskutuar dhe për tu rishikuar në të ardhmen.

Kryetari – me intereson të dijë me emra se kush ka harxhuar më së shumti për karburant me veturat zyrtare të Kuvendit?

Ismet Krasniqi – sqaroi se vetura e shpenzimeve më të larta është e ish anëtarit të kryesisë nga komuniteti 6+, Albert Kinolli. Njoftoi se anëtarët e kryesisë, kanë shpenzime pa limit për karburant.

Kryetari – kërkoj nga ju zotëri sekretar ti përcillni vërejtjet sekretarit për shpenzimet e larta për ish anëtarin e kryesisë nga komuniteti 6+, për ish këshilltarin e kryetarit për shpenzimet e mëdha që ka bërë për karburant, në mënyrë që mos të përsëriten shpenzimet e njëjta të larta në të ardhmen.

Ismet Krasniqi - sqaroi se qendra protokollare Vila Gërmia, është një objekt që në gjuhen e mjekëve të themi është një lloj kanceri i buxhetit të Kuvendit. Janë investuar 1,700 milion euro, por prej vitit 2006 punët kanë ngecur edhe nuk ka as një lëvizje në këtë drejtim. Punët e përfunduara ja kanë nis të shkatërrohen, ska pas projekt final kur ka startu puna dhe kjo ka qenë pretekst me shkue në gjykatë. Më 17 korrik 2006 seanca ka marr vendim që të vazhdohen punimet dhe deri më tani nuk është vazhdue asnjë punim sepse punëkryerësi e ka anuluar projektin final edhe aty ka ngec puna. Lënda është në gjykatë dhe Kryesia ka marrë një vendim se deri në përfundim të procesit gjyqësor lënda është në pritje. Sa i përket investimeve në ndërtesë, ne e dimë se objekti është i vjetër dhe korrigjohen investimet dhe

nganjëherë po duhet me ju përshtat rrethanave të cilat po kërkohen. Me gjithë këto investime që janë bërë nuk ka hapësira të reja po ato investime janë bërë të lirohet inventari, tepsonat e kushtet tjera të punës për administratën dhe deputetët. Në këtë aspekt, diku rreth 35 zyra i shfrytëzon Presidenca e Kosovës, pastaj i kemi dy agjenci të pavarura brenda kuvendit, dhe po mos të ishin këto institucione, kishim pas hapësira të mjaftueshme dhe nuk ishte ardhur deri te deputetët pa zyre. Pyetja për shpenzimet gjyqësore, ka qenë një lëndë dhe kemi pasur disa probleme me punëkryerësin dhe përmes përmbaruesit privat pa na pyetur, ka tërhequr mjetet prej llogarisë “servisimi i paisjeve”. Sa i përket pagesës së asistentëve të grupeve parlamentare, ne duhet me dokumentue, se stafi mbështetës fillon punën në momentin kur fillon punën kryetari apo grupi parlamentar dhe e dimë se nuk kemi pasur grup parlamentar deri në konstituivin e Kuvendit dhe zyrtari i tillë nuk mundet me qenë në listën e pagave.

Fikrim Damka- janë disa shuma të mëdha për disa kategori, por është një shumë e vogël për një biletë të aeroplanit për Washington, si e keni gjetë at biletë, apo është ndoshta një gabim teknik? Por edhe shuma prej 1,000 euro për ora të dorës, a është ndonjë dhuratë apo?

Ismet Krasniqi – shpenzimet për orë dore, janë dhuratat apo një orë që i blihen zyrtarëve të administratës që i kanë bërë dhjetë vjet përvojë pune në Kuvend, por edhe për ata zyrtar që dalin në pension.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këto

Rekomandime

- I. Të miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2014.
- II. Kryesia e Kuvendit, të rishikojë Vendimin e Kuvendit të Kosovës nr.02/229-1/06 të datës 17 korrik 2006, për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e “Qendrës Administrative Protokollare” në Gërmë, dhe Kuvendit t’ia paraqet propozimin.
- III. Agjencitë e pavarura të vendosura në ndërtesën e Kuvendit, t’i lirojnë zyre, me qëllim të krijimit të hapësirave për punë për deputetë.

6. Të ndryshme

6.1. Kryetari – është një kërkesë e autoriteti kosovar të konkurrencës, që konsideroj duhet mos ta shqyrtojmë me shumë seriozitet, se këta më herët kanë kërkuar me aprovue rrezikshmërinë në punë për inspektorët dhe tani kanë kërkuar me ia heq rrezikshmërinë për drejtorin e departamentit të tregut dhe si duket është një çështje e mosmarrëveshjes në mes tyre dhe mendojë se ne duhet refuzuar, pasi çështja e shtesave rregullohet me ligjit për pagat e nëpunësve civil, ndërkaq kërkesat buxhetore nuk janë objekt tani.

6.2. Kryetari – unë nuk kam qenë këtu deri sa është miratuar plani i punës i komisionit për vitin 2015 dhe unë kam pasur dy kërkesa: që pjesë e planit të jetë hartimi i projektligjit të lojërave të fatit në muajin maj dhe hartimin e projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare në muajin prill. Po ashtu mendojë se programi i punës të mund të plotësohet me kërkesa që kanë deputetë me bë ndonjë hulumtim të zbatueshmërisë së ligjeve pas miratimit të kërkesës në komision.

Safete Hadergjonaj – këto dy projektligje janë vazhdimësi e punës që kemi bërë mandatin e kaluar. Projektligjin për mikrofinancat e kemi ngritur në mbledhjen e kaluar dhe mbase nuk ishte këtu nuk e

kemi futur në planin e punës, por mendoj se duhet te futen ne planin e punës dhe besojë se do ta kemi mirëkuptimin edhe të anëtarëve tjerë të komisionit. Ne i kemi paraparë edhe ligje me i monitorue ,dhe në ligjin që kemi paraparë në pjesën e parë të vitit, të formojmë një grup punues në mënyrë që të fillohet me punë dhe përgatitjen e planit të veprimit për monitorim apo angazhimin e ndonjë eksperti. Po ashtu ne kemi paraparë të caktojmë një grup punues për të rishikuar rekomandimet e komisionit lidhur me monitorimin e ligjit të prokurimit publik dhe të shikojmë si të ecim më tutje. Gjithashtu, kërkojë një informatë lidhur me atë se a ka dërguar Fondi Pensional në Kuvend, kërkesën për miratimin e taksave vjetore, pasi që miratimi i taksës menaxhuese në Kuvend, është i ndërlidhur me zbatimin e buxhetit të këtij fondi.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani